REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

Petrit Malaj
Ministër

petrit__malaj
Petrit.MalajPM

FINANCA

Buletini Mujor | TETOR 2026



MINISTRI MALAJ NË KONFERENCËN E KRYETARËVE: PROJEKTBUXHETI 2027, MBI 10 MILIARDË EURO SHPENZIME PUBLIKE

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, prezantoi sot në Konferencën e Kryetarëve projektbuxhetin e shtetit për vitin 2027, i cili reflekton prioritetet e qeverisë për mbështetjen sociale, zhvillimin ekonomik dhe garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike, në funksion të objektivit për integrimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në fjalën e tij, ministri Malaj theksoi se projektbuxheti i vitit 2027 mbështetet në tri prioritete themelore: mirëqenien sociale dhe mbështetjen për qytetarët; stabilitetin fiskal dhe qëndrueshmërinë e financave publike; si dhe investimet, reformat dhe integrimin evropian. Projektbuxheti parashikon mbi 10 miliardë euro shpenzime publike, të cilat synojnë të mbështesin këto prioritete përmes financimit të politikave sociale, arsimit, shëndetësisë, pensioneve, bujqësisë, si dhe mbrojtjes dhe sigurisë.


LEXO MË SHUMË

"PROJEKTBUXHETI 2027, RRISIM MBËSHTETJEN SOCIALE DHE VIJOJMË FINANCIMIN E SEKTORËVE PRIORITARË"

Ministri i Financave, Petrit Malaj, prezantoi në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat Projektbuxhetin 2027, i cili parashikon për herë të parë mbi 10 miliardë euro shpenzime publike. Gjatë fjalës së tij, ministri paraqiti ecurinë ekonomike dhe treguesit kryesorë fiskalë që kanë shërbyer si bazë për hartimin e buxhetit, duke theksuar se një nga prioritetet kryesore mbetet rritja e mirëqenies dhe mbështetja për pensionistët. Në këtë drejtim, Projektbuxheti 2027 parashikon afrimin e indeksimit të pensioneve në muajin prill, me një fond shtesë prej rreth 1.35 miliardë lekësh, si dhe dyfishimin e bonusit mujor për pensionistët, sipas kategorive përkatëse, duke filluar nga 1 janari 2027. Për këtë politikë është parashikuar një fond prej 20 miliardë lekësh, ndërsa në total, indeksimi dhe afrimi i tij në kohë do t'i kushtojnë buxhetit rreth 4 miliardë lekë ose 40 milionë euro.

LEXO MË SHUMË





PERFORMANCA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-SHTATOR 2026

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Shtator reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve. Të ardhurat totale për 9-mujorin arritën në rreth 626.6 miliardë lekë, një realizim në masën 100.3% të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, u rritën me rreth 63.7 miliardë lekë ose 11.3 % më shumë, një realizim në masën 76.1% të planit vjetor të mbledhjes së të ardhurave. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 9-mujore të vitit 2026, arritën në rreth 556.3 miliardë lekë me një realizim në masën 92.8% të planit të periudhës, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 ky zë ka rezultuar 7.5% më i lartë ose rreth 39 miliardë lekë më shumë.


LEXO MË SHUMË



MIRATOHET PROJEKTLIGJI "PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT"

Kuvendi miratoi projektligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", që synon forcimin e integritetit të sistemit financiar, sigurisë ekonomike dhe përmbushjen e angazhimeve të Shqipërisë në procesin e integrimit evropian, në kuadër të Kapitullit 4 të negociatave. Projektligji përafron legjislacionin shqiptar me katër akte kryesore të BE-së, duke e bërë Shqipërinë vendin e parë në Ballkanin Perëndimor që realizon këtë përafrim në këtë fushë. Ndryshimet forcojnë mbikëqyrjen dhe kapacitetet institucionale, bashkëpunimin kombëtar e ndërkombëtar, si dhe shkëmbimin e informacionit për parandalimin dhe luftën kundër krimit financiar.

LEXO MË SHUMË



MINISTRI PETRIT MALAJ NË KUVEND: NDRYSHIME LIGJORE PËR MODERNIZIMIN E SISTEMIT FINANCIAR DHE SHËRBIMET BANKARE

Ministri Petrit Malaj prezantoi në Kuvend dy projektligje që synojnë modernizimin e sistemit financiar dhe shërbimet bankare në vendin tonë, si dhe përafrimin e legjislacionit shqiptar me standardet e BE. Ministri theksoi se ndryshimet në ligjin "Për sistemin e pagesave" dhe në ligjin "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" synojnë vendosjen e rregullave më të qarta për ofruesit e shërbimeve financiare, rritjen e sigurisë së transaksioneve dhe krijimin e kushteve më të barabarta të konkurrencës. Ndryshimet do të kontribuojnë gjithashtu në zhvillimin e pagesave elektronike, zgjerimin e alternativave të shërbimeve financiare dhe uljen e kostove për qytetarët dhe bizneset, duke krijuar një treg financiar më modern, konkurrues dhe të sigurt.

LEXO MË SHUMË

MBLIDHET KOMITETI DREJTUES I PROJEKTIT "FINANCAT LOKALE", DISKUTOHEN ARRITJET E VITIT 2026

Komiteti Drejtues i projektit "Financat Lokale" diskutoi arritjet e projektit gjatë vitit 2026. Ndër rezultatet më të rëndësishme u vlerësua mbështetja për hartimin e Programeve Buxhetore Afatmesme dhe zhvillimi i platformës "Financat e Vetëqeverisjes Vendore", e cila mundëson akses në të dhënat financiare dhe buxhetore, shkëmbimin e informacionit ndërmjet bashkive dhe Ministrisë së Financave, si dhe monitorimin e performancës financiare. Një vëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimit të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Financave Publike Vendore (AFMIS Vendor), i cili synon të standardizojë proceset financiare, të integrojë të dhënat dhe të përmirësojë transparencën, efikasitetin dhe cilësinë e vendimmarrjes në nivel vendor.



LEXO MË SHUMË

KUVENDI MIRATON NDRYSHIMET LIGJORE NË LIGJIN "PËR SHËRBIMET E PAGESAVE"

Kuvendi miratoi projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 55/2020, "Për shërbimet e pagesave"", i cili synon përafrimin e tregut financiar shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian, në linjë me objektivin e qeverisë për reduktimin e përdorimit të parasë cash dhe zgjerimin e shërbimeve elektronike. Përmes tij forcohet kuadri ligjor për shërbimet e pagesave dhe paranë elektronike, duke rritur sigurinë e transaksioneve, mbrojtjen e konsumatorëve dhe duke synuar uljen e kostove të shërbimeve financiare. Projektligji përditëson gjithashtu kuadrin ligjor për institucionet e parasë elektronike, duke përcaktuar në nivel ligjor kërkesat për licencimin, kapitalin, mbrojtjen e fondeve të klientëve dhe mbikëqyrjen, në përputhje me legjislacionin evropian.



LEXO MË SHUMË

© Ministria Financave 2026 - Të gjitha të drejtat e rezervuara.